



PRO

GBC18V-32PS


Robert Bosch Power Tools GmbH
70538 Stuttgart
GERMANY

www.bosch-pt.com

1 609 92A E1P (2026.05) 0 / 21



1 609 92A E1P





sq Manuali original i përdorimit







Shqip..... Faqe 8








GBC18V-32PS

A

B



D

Shqip

Udhëzime sigurie

Paralajmërimet të përgjithshme sigurie për veglat elektrike

PARALAJMËRIM Lexoni të gjitha paralajmërimet e sigurisë, instruksionet, ilustrimet dhe specifikimet e ofruara me këtë

vegël elektrike. Mosndjekja e të gjitha instruksioneve të renditura më poshtë mund të rezultojë në goditje elektrike, zjarr dhe/ose plagosje të rëndë.

Ruani të gjitha paralajmërimet dhe instruksionet për t'u referuar në të ardhmen.

Termi "vegël elektrike" në paralajmërimet e referohet veglës elektrike (me kordon) që punon me energji nga rrjeti elektrik ose veglës elektrike (pa kordon) që punon me energji nga bateria.

Siguria e vendit të punës

► Mbani vendin e punës të pastër dhe të ndriçuar mirë.

Vendet e rremujshme ose të errëta përbëjnë shkak për aksidente.

► Mos i përdorni veglat elektrike në atmosfera shpërthyes, si për shembull në prani të lëngjeve, gazeve ose pluhurit të ndezshëm. Veglat e punës krijojnë shkëndija që mund të ndezin pluhurin ose avujt.

► Mbani larg fëmijët dhe kureshtarët gjatë përdorimit të veglës elektrike. Tërheqja e vëmendjes mund të bëjë që të humbni kontrollin.

Siguria elektrike

► Mos i ekspozoni veglat elektrike në shi ose kushte të lagështa. Uji që hyn në një vegël elektrike do të rritë rrezikun për goditje elektrike.

Siguria e personit

► Qëndroni vigjilent, shikoni çfarë po bëni dhe përdorni logjikën e zakonshme kur përdorni një vegël elektrike. Mos përdorni vegël elektrike nëse jeni të lodhur apo nën ndikimin e drogës, alkoolit apo të ilaçeve. Një moment pakujdesie gjatë përdorimit të veglave elektrike mund të rezultojë në plagosje të rëndë të personit.

► Përdorni pajisje mbrojtëse personale. Vendosi gjithmonë mbrojtje për sytë. Pajisjet mbrojtëse, të tilla si maska kundër pluhurit, këpucët e sigurisë që nuk rrëshqasin, helmata e punës ose mbrojtja e dëgjimit sipas rrethanave të përshatshme, zvogëlon mundësinë për plagosje të personit.

► Parandaloni ndezjen aksidentale. Sigurohuni që çelësi është në pozicionin fikur përpara se ta lidhni pajisjen me burimin e energjisë dhe/ose baterinë, përpara se ta kapni apo të transportoni veglën. Mbrojtja e veglave elektrike me gishtin të çelësi ose ushqimi me energji i veglave elektrike përbën shkak për aksidente.

► Hiqni çdo çelës rregullues ose shtrëngues përpara se të ndizni veglën elektrike. Çelësi shtrëngues ose rregullues i mbetur në një pjesë rrotulluese të veglës elektrike mund të rezultojë në plagosje të personit.

► Mos u zgjatni shumë. Ruani mbështetjen e duhur me këmbë dhe ekuilibrin në çdo kohë. Kjo mundëson kontroll më të mirë të veglës elektrike në rrethana të papritura.

► Vishuni si duhet. Mos vishni veshje të gjera ose mos mbani bizhuteri. Mbani flokët dhe veshjet larg nga pjesët rrotulluese. Veshjet e lira, bizhuteritë ose flokët e gjatë mund të kapen në pjesët rrotulluese.

► Nëse pajisje janë parashikuar me lidhje për thithjen e pluhurit dhe të objekteve mbledhëse, sigurohuni që këto janë të lidhura dhe përdoren si duhet. Përdorimi i mbledhjes së pluhurit mund të zvogëlojë rreziqet që lidhen me pluhurin.

► Mos lejoni që familjariteti i krijuar nga përdorimi i shpeshtë i veglave elektrike t'ju bëjë mospërfillës dhe të neglizhoni parimet e sigurisë së veglave elektrike. Një veprim i pakujdesshëm mund të shkaktojë plagosje të rëndë në fraksionin e një sekonde.

Përdorimi dhe kujdesi për veglat elektrike

► Mos ushtroni forcë mbi veglën elektrike. Përdorni veglën e duhur elektrike për qëllimin tuaj. Vegla e duhur elektrike do ta kryejë punën më mirë dhe më saktë në shpejtësinë me të cilën është projektuar.

► Mos e përdorni veglën elektrike nëse çelësi nuk ndizet dhe nuk fiket. Çdo vegël elektrike që nuk mund të komandohet është e rrezikshme dhe duhet riparuar.

► Shkëputni spinën nga burimi i energjisë dhe/ose hiqni baterinë nga vegla elektrike, nëse çmontohet, përpara se të kryeni ndonjë rregullim, të ndërmoni aksesorët ose përpara se t'i vendosni veglat elektrike në ruajtje. Këto masa parandaluese të sigurisë zvogëlojnë rrezikun e ndezjes aksidentale të veglës elektrike.

► Ruani veglat elektrike që nuk i përdorni larg fëmijëve dhe mos lejoni përdorimin e veglës elektrike nga persona që nuk e njohin veglën elektrike ose nuk i dinë këto instruksione. Veglat elektrike janë të rrezikshme në duart e përdoruesve pa përvojë.

► Mirëmbani veglat elektrike dhe aksesorët. Kontrolloni për devijim ose ngjitje të pjesëve lëvizëse, thyerje të pjesëve ose për ndonjë gjendje tjetër që mund të ndikojë në funksionimin e veglës elektrike. Nëse është dëmtuar, riparoni veglën elektrike përpara përdorimit. Shumë aksidente janë shkaktuar nga mirëmbajtja e dobët e veglave elektrike.

► Mbani të pastra dhe të mprehta veglat prerëse. Veglat prerëse të mirëmbajtura si duhet me tehe të mprehta kanë më pak gjasa të ngecin dhe kontrollohen më lehtë.

► Përdorni veglën elektrike, aksesorët dhe majat e veglave etj. në përputhje me këto instruksione, duke marrë parasysh kushtet e punës dhe punën që do të kryhet. Përdorimi i veglave elektrike për veprime të

ndryshme nga ato të parashikuara mund të rezultojnë në situatë të rrezikshme.

- **Mbani të pastra, të thata dhe pa vaj e graso dorezat dhe sipërfaqet e kapjes.** Dorezat dhe sipërfaqet e rrëshqitshme të kapjes nuk mundësojnë manovrimin dhe kontrollin e sigurt të veglës në rrethana të papritura.

Përdorimi dhe kujdesi i veglave me bateri

- **Kryeni karikimin vetëm me karikuesin e specifikuar nga prodhuesi.** Një karikues që është i përshtatshëm për një tip baterie mund të përbëjë rrezik për zjarr kur përdoret me një paketë tjetër baterie.
- **Përdorni veglat elektrike vetëm me paketat e baterisë të projektuara në mënyrë të posaçme.** Përdorimi i paketave të tjera të baterisë mund të paraqesë rrezik për plagosje dhe zjarr.
- **Kur paketa e baterisë nuk është në përdorim, mbajeni atë larg objekteve të tjera metalike, si për shembull kapëset e letrave, monedhat, çelësat, gozhdët, vidat ose objektet e tjera të vogla metalike, të cilat mund të krijojnë një lidhje nga një terminal tek tjetri.** Lidhja shkurt së bashku e terminaleve të baterisë mund të shkaktojë djegie ose zjarr.
- **Në kushte abuzimi, nga bateria mund të rrjedhë lëng; shmangni kontaktin me lëngun.** Nëse ndodh kontakt aksidental, shpëlajeni me ujë. Nëse lëngu bie në kontakt me sytë, kërkonti gjithashtu ndihmë mjekësore. Lëngu i rrjedhur nga bateria mund të shkaktojë irritim ose djegie.
- **Mos e përdorni një paketë baterie ose vegël që është dëmtuar ose modifikuar.** Bateritë e dëmtuara ose të modifikuara mund të shfaqin sjellje të paparashikueshme, duke rezultuar në zjarr, shpërthim ose rrezik plagosjeje.
- **Mos e ekspozoni paketën e baterisë ose veglën në zjarr ose temperaturë shumë të lartë.** Ekspozimi në zjarr ose temperaturë mbi 130°C mund të shkaktojë shpërthim.
- **Ndiqui të gjitha instruksionet e karikimit dhe mos e karikoni paketën e baterisë ose veglën përtej diapazonit të temperaturave të specifikuara në instruksione.** Karikimi në mënyrë të papërshtatshme ose në temperatura përtej diapazonit të specifikuar mund të dëmtojë baterinë dhe rrit rrezikun për zjarr.

Shërbimi

- **Kryeni shërbimin e veglës elektrike te një teknik i kualifikuar duke përdorur vetëm pjesë këmbimi identike.** Kjo do të garantojë ruajtjen e sigurisë së veglës elektrike.
- **Mos u bëni kurrë shërbim paketave të dëmtuara të baterive.** Shërbimi i paketave të baterive duhet bërë vetëm nga prodhuesi ose nga ofruesit e autorizuar të shërbimit.

Udhëzime sigurie për prerësit e shufrave të hekurit



Mbajini duart larg hapësirës së prerjes dhe tehut rrotullues të sharrës. Mund të lëndoheni seriozisht.



Mbajeni gjithmonë produktin me të dyja duart nga dorezat e caktuara dhe mos e futni kurrë dorën në hapësirën e prerjes gjatë përdorimit. Mbajini dorezat të thata, të pastra dhe pa vaj dhe yndyrë. Në këtë mënyrë, mund të punoni mirë dhe sigurt.

- **Mos e përdorni kurrë pajisjen elektrike pa pllakën bazë.** Vetëm kur e keni pllakën bazë të montuar mund të punoni mirë dhe sigurt.
- **Përdorni vetëm tehe sharre që janë të miratuara për produktin e që plotësojnë specifikimet te të dhënat teknike.** Aplikimi i tehut të sharrës në mënyra të tjera mund të shkaktojë konsumim të tepërt, shkëputjen e tehut, ulje në performancën e prerjes dhe gjenerim të tepërt nxehtësie, të cilat mund ta dëmtojnë tehun e sharrës dhe të shkaktojnë lëndime serioze.
- **Mos përdorni asnjë teh sharre të mpirë ose të dëmtuar.** Një teh sharre me dhëmbë të mpirë ose të çrregullt shkakton rritje fërkimi, bllokimin e tehut të sharrës dhe kundërgoditje për shkak të një hapësire prerëse shumë të ngushtë.
- **Përdorni pajisje të përshtatshme kërkimi, për të gjetur linjat e fshehura të shërbimeve ose konsultohuni me kompaninë lokale të shërbimeve.** Kontakti me telat elektrikë mund të shkaktojë zjarr dhe goditje elektrike. Dëmtimi i një linje gazi mund të shkaktojë një shpërthim. Depërtimi në një tub uji shkakton dëme materiale.
- **Kapeni mjetin me korrent vetëm nga sipërfaqet e izoluara të kapjes kur bëni ndonjë punë në të cilën aksesori prerës mund të kontaktojë telat e fshehur ose kordonin e vet.** Në rast kontakti me një tel me korrent, pjesët metalike të ekspozuara të mjetit me korrent mund të marrin korrent dhe t'i shkaktojnë operatorit goditje elektrike.
- **Ndizeni pajisjen elektrike vetëm pasi ta keni vendosur në pozicionin e punës dhe ta mbani fort me të dyja duart.** Kjo do t'ju ndihmojë të shmangni një kundërgoditje të pakontrolluar.
- **Gjatë punës mund të prodhohen çipe metalike të nxehta dhe me tehe të mprehta, të cilat mund të shkaktojnë prerje dhe djegie nëse bien në kontakt me lëkurën.** Vishni rroba që rrinë pas trupit.
- **Mos e filloni prerjen derisa pajisja elektrike të ketë arritur shpejtësinë e vet maksimale.** Kontakti midis pjesës së punës dhe tehut të sharrës para se të ndizet motori çon në mbingarkesë dhe dëmtim të tehut të sharrës dhe mund të rezultojë në lëndime serioze.
- **Nëse ndodh një kundërgoditje, mos e vazhdoni më procesin e prerjes në pjesën e punës. Hiqeni pajisjen**

elektrike nga pjesa e punës, lëreni tehun e sharrës të arrijë shpejtësinë e plotë dhe vazhdoni me kujdes prerjen. Kur pajisja elektrike rindizet në pjesën e punës, tehu i sharrës mund të bllokohet përsëri ose të shkaktojë një kundërgoditje.

- ▶ **Nëse tehu i sharrës ngec ose bllokohet në prerje, bllokimi mund të shkaktojë kundërgoditje.** Kjo mund të çojë në lëvizje të pakontrolluara të pajisjes elektrike.
- ▶ **Gjatë punës, mund të krijohen shkëndija dhe çipa të nxehta metalike, të cilat mund ti ndezin materialet lehtësisht të ndezshme aty pranë ose të dëmtojnë sipërfaqet.** Sigurohuni që të mos ketë materiale të ndezshme në mjedisin e punës dhe mbrojin sipërfaqet e ndjeshme.
- ▶ **Shmangni prekjen e kokës së pajisjes elektrike gjatë funksionimit.** Ajo mund të nxeht shumë dhe ju mund të lëndoheni.
- ▶ **Tehu i sharrës dhe pjesët e tjera metalike mund të jenë të nxehta ose të kenë skaje të mprehta.** Kur ta ndërroni tehun e sharrës vishni doreza mbrojtëse.
- ▶ **Kur punoni në lartësi, sigurohuni që askush të mos jetë në zonën poshtë.** Çipat ose mbetjet e materialeve që bien mund të shkaktojnë aksidente.
- ▶ **Mos e ulni kurrë pajisjen elektrike në tokë derisa pajisja të ndalet plotësisht.** Vegla shtesë rrotulluese mund t'ju dëmtoj seriozisht dorën ose të prekë sipërfaqen e punës dhe të lëvizë në mënyrë të pakontrollueshme.
- ▶ **Nëse bateria është dëmtuar ose përdoret në mënyrë jo të duhur, mund të dalin avuj. Bateria mund të digjet ose të shpërthejë.** Dilni në ajër të freskët dhe flisni me një mjek në rast se keni shqetësime. Avujt mund të irritojnë sistemin e frymëmarrjes.
- ▶ **Mos e modifikoni ose hapni baterinë.** Ekziston rreziku i një qarku të shkurtër.
- ▶ **Bateria mund të dëmtohet nga objekte të mprehta të tilla si gozhdë ose kaçavida ose nga forca të jashtme.** Mund të ndodhë një qark i shkurtër i brendshëm dhe bateria mund të digjet, të nxjerë tym, të shpërthejë ose të mbinxehet.
- ▶ **Përdorni baterinë vetëm në produktet e prodhuesit.** Vetëm kështu mund të mbroini baterinë nga mbingarkesat e rrezikshme.



Mbroini baterinë nga nxehtësia, p.sh. nga rrezet e vazhdueshme të diellit, zjarri, papastërtia, uji dhe lagështia. Ekziston rreziku i shpërthimit dhe i qarkut të

shkurtër.

Simbole

Simbolet e mëposhtme mund të jenë të rëndësishme për përdorimin e veglës suaj elektrike. Ju lutemi mbani mend simbolet dhe kuptimin e tyre. Interpretimi i saktë i simboleve do t'ju ndihmojë ta përdorni më mirë dhe në mënyrë më të sigurt veglën elektrike.



Mbani syze mbrojtëse.

Përshkrimi i produktit dhe shërbimit



Lexoni të gjitha paralajmërimet dhe udhëzimet e sigurisë. Mosrespektimi i paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë mund të rezultojë në goditje elektrike, zjarr dhe/ose lëndim serioz.

Ju lutemi vini re ilustrimet në pjesën e përparme të udhëzimeve të përdorimit.

Përdorimi në përputhje me qëllimin e duhur

Pajisja elektrike është projektuar për prerje të sheshtë ose të lirë të shufrave me fileto prej çeliku përforcues dhe çeliku të butë që përdoren në industrinë e ndërtimit.

Komponentët e shfaqur

Numërimi i komponentëve të paraqitur i referohet paraqitjes së veglës elektrike në faqen grafike.

- (1) Shigjeta e drejtimit të rrotullimit në kasë
- (2) Butoni i bllokimit të boshtit
- (3) Ndërfaqja e përdoruesit
- (4) Bateria^{a)}
- (5) Filtër pluhuri (2x)
- (6) Butoni i lirim të baterisë^{a)}
- (7) Leva e lëshimit për çelësin e ndezjes/fikjes
- (8) Çelësi i ndezjes/fikjes
- (9) Butoni për të rrotulluar marshin
- (10) Dorezë shtesë kundër dridhjeve (sipërfaqe e izoluar e dorezës)
- (11) Çelës heksagonal i brendshëm
- (12) Dalja
- (13) Vidë për rregullimin e gjerësisë së hapjes
- (14) Teh sharre
- (15) Ndihmë drejtimi
- (16) Dorezë (me sipërfaqe të izoluar)
- (17) Ekran i temperaturës (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (18) Treguesi për gjendje të ulët karikimi të baterisë (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (19) Treguesi i gjendjes së pajisjes elektrike (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (20) Treguesi i fikjes së goditjes mbrapsht (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (21) Treguesi i mbingarkesës (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (22) Butoni i rritjes së shpejtësisë (Ndërfaqja e përdoruesit)

- (23) Treguesi për nivelin/modalitetin e shpejtësisë (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (24) Butoni i uljes së shpejtësisë (Ndërfaqja e përdoruesit)
- (25) Vida (4 x)
- (26) Pillaka bazë
- (27) Vidë tensioni
- (28) Fllanxhë shtrënguese
- (29) Kunj qendror (3 x)
- (30) Mbajtëse për qesen e çipave
- a) **Këto pajisje shtesë nuk janë pjesë e dorëzimeve standarde.**

Të dhënat teknike

Prerës hekuri përforcues	GBC18V-32PS	
Numri i artikullit	3 601 JS7 0..	
Tension nominal	V=	18
Shpejtësia boshe	min ⁻¹	1700–2000
Kapaciteti i ndarjes për hekurin përforcues	mm	10–32
Diametri i tehut të sharrës	mm	136
Fikja e goditjes mbrapsht		●
Siguresë mbrojtëse		●
Fren ndërprerës		●
Fillim i butë		●
Fikja e goditjes		●
Mbrojtja nga mbingarkesa		●
Parazgjedhja e shpejtësisë së rrotullimit		●
Pesha ^{A)}	kg	3,3
Përmasat (Gjatësia x Gjerësia x Lartësia)	mm	445 x 186 x 114
temperatura e rekomanduar e ambientit gjatë karikimit	°C	0 ... +35
temperatura e lejuar e ambientit gjatë funksionimit ^{B)} dhe gjatë ruajtjes	°C	–20 ... +50
bateritë e përputhshme	GBA18V... GBA 18V... ProCORE18V... EXPERT18V... EXBA18V... CORE18V...	
bateritë e rekomanduara për performancë të plotë	ProCORE18V... ≥ 8.0 Ah EXPERT18V... ≥ 5.5 Ah	
karikuesit e rekomanduar	GAL18... GAL 18... GAL 36... GAL 12V/18... GAL 12V/18...	

Prerës hekuri përforcues

GBC18V-32PS

GAX 18...

EXAL18...

A) Pa bateri (peshën e baterisë mund ta gjeni në www.bosch-professional.com)

B) Performancë e kufizuar në temperatura < 0 °C

Vlerat mund të ndryshojnë sipas produktit dhe i nënshtrohen kushteve të aplikimit dhe mjedisit. Informacione të mëtejshme në www.bosch-professional.com/wac.

Informacion mbi zhurmën/dridhjet

Vlerat e emetimit të zhurmës përcaktohen në përputhje me **EN 62841-1**.

Niveli i ponderuar i zhurmës A i veglës elektrike është zakonisht: Niveli i presionit të zërit **96 dB(A)**; Niveli i fuqisë së zërit **104 dB(A)**. Pasiguria K = **3 dB**.

Mbani mbrojtje për veshët!

Vlerat e dridhjeve a_h (dridhjet e vazhdueshme), p_r (dridhjet e përsëritura të goditjes) dhe pasiguria K e përcaktuar në përputhje me **EN 62841-1**:

$a_h = 3,8 \text{ m/s}^2$, $K = 1,5 \text{ m/s}^2$, $p_r = 410,8 \text{ m/s}^2$ ($K = 82,8 \text{ m/s}^2$)

Niveli i dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës të dhëna në këto udhëzime janë matur sipas një metode matëse të standardizuar dhe mund të përdoren për të krahasuar veglat elektrike me njëra-tjetrën. Ato janë gjithashtu të përshtatshme për një vlerësim paraprak të emetimeve të dridhjeve dhe zhurmës.

Niveli i dhënë i dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës përfaqësojnë aplikimet kryesore të veglës elektrike. Megjithatë, nëse vegla elektrik përdoret për përdorime të tjera, me mjete të ndryshme ose me mirëmbajtje të pamjaftueshme, niveli i dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës mund të ndryshojnë. Kjo mund të rrisë ndjeshëm emetimet e dridhjeve dhe zhurmës gjatë gjithë periudhës së punës.

Për një vlerësim të saktë të emetimeve të dridhjeve dhe zhurmës, duhet të merren parasysh edhe kohët kur pajisja është e fikur ose është në punë, por nuk është në përdorim. Kjo mund të reduktojë ndjeshëm emetimet e dridhjeve dhe zhurmës gjatë gjithë periudhës së punës.

Vendosni masa shtesë sigurie për të mbrojtur operatorin nga efektet e dridhjeve, të tilla si: mirëmbajtja e veglave dhe aksesorëve elektrikë, mbajtja e duarve të ngrohta, organizimi i proceseve të punës.

Fikja e goditjes mbrapsht



Në rast të një goditjeje të papritur të veglës elektrike, p.sh. bllokimi gjatë një prerjeje, furnizimi me energji elektrike i motorit ndërpritet në mënyrë elektronike. Ndizet treguesi i valvulës së goditjes **(20)**. Kur aktivizohet fikja e goditjes, treguesi i statusit **(19)** pulson me ngjyrë të kuqe.

Për të **rindëzuar** veglën elektrike, vendosni çelësin e ndezjes/fikjes **(8)** në pozicionin e fikur dhe ndizni sërish veglën elektrike.

Mbrojtja e rifilluar



Mbrojtja e rifilluar parandalon ndezjen e pakontrolluar të veglës elektrike pas një ndërprerjeje në furnizimin me energji elektrike. Për të **rindezur** pajisjen, zhvendoseni çelësin e ndezjes/fikjes (8) në pozicionin e fikur dhe ndizni sërish veglën elektrike.

Fren ndërprerës



Vegla elektrike ka një frenim elektronik. Kur pajisja elektrike fiket, tehu i sharrës ndalon brenda pak sekondash.

Fillimi i butë

Fillimi i butë elektronik kufizon çift rrotullimet kur ndizet dhe mundëson që vegla elektrike të fillojë pa probleme.

Shënim: Nëse vegla elektrike punon me shpejtësi të plotë menjëherë pas ndezjes, mbrojtja e rifilluar dhe fillimi i butë kanë dështuar. Vegla elektrik duhet të dërgohet menjëherë te shërbimi ndaj klientit; për adresat, shihni seksionin "Shërbimi ndaj klientit dhe këshilla për përdorim".

Fikja e goditjes



Fikja e goditjes e integruar fik veglën elektrike në momentin që ajo takon tokën pas një rrëzimi. Për të **rindezur**, zhvendoseni çelësin e ndezjes/fikjes (8) në pozicionin e fikur dhe ndizni sërish veglën elektrike.

Mbrojtja nga mbingarkesa

Kur përdoret sipas qëllimit, vegla elektrike nuk mund të mbingarkohet. Nëse ngarkesa është shumë e lartë ose tejkalohet diapazoni i temperaturës së baterisë, ajo fiket automatikisht. Më pas fikni veglën elektrike dhe ndaloni punën që shkaktoi mbingarkimin e veglës elektrike. Më pas ndizni sërish veglën elektrike për të rifilluar procesin e punës.

Parazgjedhja e shpejtësisë së rrotullimit

2 nivele shpejtësie janë paracaktuar në cilësimet e fabrikës.

Niveli i parazgjedhjes së shpejtësisë	[min ⁻¹]
1	1700
2	2000

Nivelet e specifikuar të shpejtësisë varen nga bateria e përdorur, niveli i karikimit të baterisë dhe temperatura e funksionimit të pajisjes.

Mund të përdorni butonat e përcaktimit të shpejtësisë (22) dhe (24) gjithashtu mund të zgjidhni paraprakisht shpejtësinë e kërkuar. Informacionet në tabelën e mëposhtme janë vlerat e rekomanduara.

Material	Përdorimi	Vegla që përdoret	Niveli i shpejtësisë
Hekur përforcues	Ndarja	Teh sharre	1/2
Shufra me fileto çeliku të butë	Ndarja	Teh sharre	1/2

Mos e filloni prerjen derisa produkti të ketë arritur shpejtësinë maksimale të rrotullimit. Nëse e vini tehu në sharrës në kontakt me pjesën e punës përpara se të ndizni motorin, tehu i sharrës do të mbingarkohet dhe do të dëmtohet, gjë që mund të çojë në lëndime serioze. Zgjidhni nivelin 2 për shpejtësinë më të lartë të prerjes. Zgjidhni nivelin 1 për të zvogëluar shkëndijat.

Bateria

Bosch shet vegla elektrike me bbateri dhe pa bateri. Nga paketimi mund të mësoni nëse me veglën tuaj elektrike është e përfshirë një bateri.

Karikoni baterinë

► **Përdorni vetëm karikuesit e listuar në të dhënat teknike.** Vetëm këta karikues janë përshtatur për baterinë Li-jon të përdorur në veglën tuaj elektrike.

Shënim: Bateritë Li-jon dorëzohen pjesërisht të karikuara për shkak të rregulloreve ndërkombëtare të transportit. Për të siguruar funksionimin e plotë të baterisë, karikoni plotësisht baterinë përpara përdorimit të parë.

Vendosni baterinë

Prëshqisni baterinë e karikuar në mbajtësen e baterisë derisa të klikojë në vend.

Hiqni baterinë

Për të hequr baterinë, shtypni butonin e lirimit të baterisë dhe tërhiqeni baterinë. **Mos përdorni forcë.**

Bateria ka 2 nivele kyçeje për të parandaluar që bateria të bjerë jashtë kur shtypet aksidentalisht butoni i lëshimit të baterisë. Për sa kohë që bateria është futur në veglën elektrike, ajo mbahet në pozicionin e saj nga një butoni.

Treguesi i nivelit të karikimit të baterisë

Shënim: Jo çdo lloj baterie ka një tregues të nivelit të karikimit.

LED-et jeshile të treguesit të statusit të karikimit të baterisë tregojnë statusin e karikimit të baterisë. Për arsye sigurie, pyetja për statusin e karikimit është e mundur vetëm kur vegla elektrike nuk është në gjendje pune.

Shtypni butonin e treguesit të statusit të karikimit  ose , për të shfaqur statusin e karikimit. Kjo është e mundur edhe nëse hiqni baterinë.

Nëse asnjë LED nuk ndizet pas shtypjes së butonit të treguesit të statusit të karikimit, bateria është me defekt dhe duhet të zëvendësohet.

Niveli i karikimit të baterisë shfaqet gjithashtu në ndërfaqen e përdoruesit (shih "Treguesi i statusit", Faqe 15).

Lloji i baterisë GBA 18V... | GBA18V...



LED	Kapaciteti
Dritë e vazhdueshme 3 × e gjelbër	60–100 %
Dritë e vazhdueshme 2 × e gjelbër	30–60 %
Dritë e vazhdueshme 1 × e gjelbër	5–30 %
Dritë pulsuese 1 × e gjelbër	0–5 %

Lloji i baterisë ProCORE18V... | EXPERT18V... | EXBA18V... | CORE18V...



LED	Kapaciteti
Dritë e vazhdueshme 5 × e gjelbër	80–100 %
Dritë e vazhdueshme 4 × e gjelbër	60–80 %
Dritë e vazhdueshme 3 × e gjelbër	40–60 %
Dritë e vazhdueshme 2 × e gjelbër	20–40 %
Dritë e vazhdueshme 1 × e gjelbër	5–20 %
Dritë pulsuese 1 × e gjelbër	0–5 %

Zbulimi i rrezikut të defektit të baterisë

EXPERT18V... | EXBA18V...

LED-et e treguesve të statusit të karikimit të baterisë mund të tregojnë rrezikun e një defekti të baterisë përveç statusit të karikimit të baterisë.

Për të aktivizuar funksionin, shtypni dhe mbani shtypur butonin e treguesit të statusit të karikimit për 3 sekonda. Analiza e baterisë sinjalizohet nga një dritë ndezëse në ekranin e statusit të karikimit të baterisë. Rezultati shfaqet në ekranin e statusit të karikimit të baterisë.

1 LED: Bateria ka një rrezik të lartë për defekt. Performanca dhe koha e funksionimit tashmë mund të reduktohen. Rekomandohet të zëvendësoni baterinë.

5 LED: Bateria është në gjendje të mirë me rrezik të ulët defekti.

Ju lutemi vini re: Vlerësimi i rrezikut të defektit të baterisë funksionon në dy faza dhe ofron një vlerësim të thjeshtuar të gjendjes. Bateria ose është vlerësuar në gjendje të mirë ose ka një rrezik të shtuar të defekteve. Nuk shfaqet asnjë përqindje e gjendjes së baterisë.

Udhëzime për trajtimin optimal të baterisë

Mbroni baterinë nga lagështia dhe uji.

Ruani baterinë vetëm në një interval temperaturash nga –20 °C deri në 50 °C. Për shembull, mos e lini baterinë në makinë gjatë verës.

Herë pas here pastrojeni hapjet e baterisë me një furçë të butë, të pastër dhe të thatë.

Një kohë tepër e reduktuar pune pas karikimit tregon që bateria është konsumuar dhe ajo duhet të zëvendësohet. Ndiqni udhëzimet e asgjësimit.

Montim

► **Përdorni vetëm tehe sharre, shpejtësia maksimale e lejuar e të cilave është më e lartë se shpejtësia e boshtit të veglës suaj elektrike.**

Çmontimi/montimi i tehut të sharrës

- **Para se të kryeni ndonjë punë në veglën elektrike (p.sh. mirëmbajtje, ndryshim i veglave, etj.) hiqeni baterinë nga vegla elektrike.** Ekziston rreziku i lëndimit nëse çelësi i ndezjes/fikjes shtypet pa dashje.
- **Vishni doreza mbrojtëse kur montoni tehun e sharrës.** Ekziston rreziku i lëndimit nëse prekni tehun e sharrës.
- **Përdorni vetëm tehe sharre që përpunohen me cilësimet e specifikuar në këtë manual dhe në mjetin elektrik.**

Çmontimi/montimi i tehut të sharrës (shih figurën A)

- Lironi 4 vidat (25) duke përdorur çelësin e dërguar heksagonal (11).
- Hiqni pllakën bazë (26).
- Shtypni dhe mbani shtypur butonin e kyçjes së boshtit (2).
- **Shtypni butonin e kyçjes së boshtit (2) vetëm kur boshti i sharrës është i palëvizshëm.** Përndryshe, pajisja elektrike mund të dëmtohet.
- Përdorni çelësin heksagonal (11) për të zhvidhosur vidën shtrënguese (27).
- Hiqni flanaxhën e fiksimit (28) dhe tehun e sharrës (14).

Montimi i tehut të sharrës (shih figurën B)

- Pastroni tehun e sharrës (14) dhe të gjitha pjesët shtrënguese që do të montoni.
- Vendosni tehun e sharrës (14). Drejtimi i prerjes së dhëmbëve (drejtimi i shigjetës në tehun e sharrës) dhe drejtimi i shigjetës së rrotullimit (1) në kasë duhet të përpunohen. Sigurohuni që 3 kunjat e qendror (29) të futen në vrimat tehut të sharrës.
- Vendosni flanaxhën shtrënguese (28) sipër dhe vidhosni vidën shtrënguese (27).
- Shtypni dhe mbani shtypur butonin e kyçjes së boshtit (2).
- Tërhiqni çelësin heksagonal (11) për të zhvidhosur vidën shtrënguese (27).
- Vendosni pllakën bazë (26) sipër dhe vidhosni atë në vend me 4 vidat (25).

Amortizues dridhesh dorezë shtesë

Shënim: Prerësi i hekurit përforcues GBC18V-32PS

përfshin një dorezë ndihmëse që zbut dridhjet. (10). Për

arsye ergonomie dhe sigurie në punë, përdorni gjithmonë dorezën shtesë kundër dridhjeve të përshkruara në këto udhëzime funksionimi (10).

Vidhosni dorezën shtesë (10) në varësi të mënyrës së funksionimit, në të djathtë ose të majtë ose sipër kokës së marsheve.

- **Përdorni veglën tuaj elektrike vetëm me dorezën shtesë (10).**
- **Ndalo përdorimin e veglës elektrike nëse doreza shtesë (10) është e dëmtuar. Mos bëni asnjë ndryshim në dorezën shtesë (10).**

Vibration Control Doreza shtesë kundër dridhjeve (10) mundëson një punë me dridhje të ulët dhe për këtë arsye më të këndshme

dhe të sigurt.

Nxjerrja e pluhurit/ashklave

Shmangni punën pa marrë masat e nevojshme kundër reduktimit të pluhurit. Një kuti pluhuri e përshtatshme nxjerrjeje pluhuri redukton ndotjen e dëmshme për shëndetin nga pluhuri. Sigurohuni që vendi i punës të jetë i ajrosur mirë. Përdorni gjithmonë mbrojtje të përshtatshme për frymëmarrjen. Për të siguruar nxjerrjen optimale të pluhurit, zbrazi kutinë e pluhurit në kohën e duhur dhe pastroni elementin e filtrit rregullisht.

- **Shmangni grumbullimin e pluhurit në vendin e punës.** Pluhuri mund të ndizet lehtësisht.

Vetë-thithja

Vendosni anën e hapur të qeses së çipave në mbajtëse (30) dhe sigurojeni atë me kordonët e tërheqjes. Tërhiqeni fort qesen e çipave për t'u siguruar që është fiksur siç duhet.

Rrotulloni marshin (shih figurën C)

- **Para se të kryeni ndonjë punë në veglën elektrike (p.sh. mirëmbajtje, ndryshim i veglave, etj.) hiqeni baterinë nga vegla elektrike.** Ekziston rreziku i lëndimit nëse çelësi i ndezjes/fikjes shtypet pa dashje.

Ju mund ta rrotulloni marshin 90° majtas ose djathtas në krahasim me dorezën. Kjo lejon që çelësi i ndezjes/fikjes (8) të zhvendoset në një pozicion më të përshtatshëm për aplikacione të veçanta.

Vendoseni çelësin e ndezjes/fikjes (8) në pozicionin "Fikur". Shtypni butonin (9) dhe rrotulloni marshin në pozicionin e dëshiruar (shih figurën C).

Çelësi i ndezjes/fikjes (8) mund të aktivizohet vetëm kur marshi të jetë në pozicionin e duhur.

Funksionimi

- **Mos e sforcni aq shumë veglën elektrike sa të ndalojë.**
- **Para se të kryeni ndonjë punë në veglën elektrike (p.sh. mirëmbajtje, ndryshim i veglave, etj.) hiqeni baterinë nga vegla elektrike.** Ekziston rreziku i lëndimit nëse çelësi i ndezjes/fikjes shtypet pa dashje.

- **Mbërtheni pjesën e punës nëse nuk është e vendosur mirë nën peshën e saj.**
- **Pas ngarkesës së madhe, lëreni veglën elektrike të punojë bosh për disa minuta për të ftohur insertin e saj.**
- **Mos e përdorni veglën elektrike me mbajtëse prerëse.**

Rregulloni gjerësinë e hapjes (shih figurën D)

Lironi vidën për rregullimin e gjerësisë së hapjes (13). Rrëshqisni bllokun e rregullimit të gjerësisë majtas ose djathtas për të arritur gjerësinë e dëshiruar të hapjes. Përpara se të filloni ndonjë punë, sigurohuni që vida (13) të jetë shtrënguar.

Këshilla pune

Perja e hekurit përforcues

Zgjidhni cilësimin e duhur për prerjen që do të kryhet (shih "Rregulloni gjerësinë e hapjes (shih figurën D)", Faqe 14).

Mos prekni asnjë pjesë rrotulluese, pasi kjo mund të shkaktojë lëndime serioze.

Mos e filloni prerjen menjëherë pasi të keni ndezur motorin. Lëreni tehun e sharrës të arrijë shpejtësinë maksimale përpara se të filloni prerjen.

Zgjidhni një shpejtësi më të ulët për të zvogëluar shkëndijat. Ngadalësoni lëvizjen përpara (lëvizjen e prerjes) si në fillim ashtu edhe në fund të procesit të prerjes.


Mos i prisni shufrat përforcuese me një diametër më të vogël se 10 mm.

Mos e prisni hekurin përforcues më pak se 20 mm gjatësi, pasi prerja mund të ngecë midis tehut të sharrës (14) dhe pllakës bazë (26) duke shkakuar dëmtime dhe lëndime serioze.

Pasi ta ndizni, lidhni fort udhëzuesin (15) në hekurin përforcues. Shtyjeni ngadalë pajisjen elektrike përpara për të filluar prerjen e hekurit.

Instalimi

Ndezja/fikja



Për të filluar **përdorimin** e veglës elektrike, shtyni levën e lirim (7) përpara dhe më pas shtypni çelësin e ndezjes/fikjes (8) për lart.

Për të **fikur** veglën elektrike, lëshoni çelësin e ndezjes/fikjes (8).

Ndërfaqja e përdoruesit

Ndërfaqja e përdoruesit **(3)** përdoret për të zgjedhur paraprakisht shpejtësinë dhe për të shfaqur statusin e veglës elektrike.

Treguesi i statusit

Treguesi i temperaturës (17)	Kuptimi/shkaku	Zgjidhja
e verdhë	Është arritur temperatura kritike (elektronikë, bateri)	Vëreni pajisjen elektrike në gjendje boshe dhe lëreni të ftohet
e kuqe	Vegla elektrike është mbinxehur dhe fiket	Lëreni veglën elektrike të ftohet
Treguesi i nivelit të karikimit të baterisë (Ndërfaqja e përdoruesit) (18)	Kuptimi/shkaku	Zgjidhja
e verdhë	Bateria pothuajse bosh	Zëvendësoni ose karikoni baterinë së shpejti
e kuqe	Bateria bosh	Zëvendësoni ose karikoni baterinë
Treguesi i statusit të veglës elektrike (19)	Kuptimi/shkaku	Zgjidhja
e gjelbër	Statusi OK	–
e verdhë	Është arritur temperatura kritike ose bateria është pothuajse bosh ose u zbulua mbingarkesë	Lëreni pajisjen elektrike në gjendje boshe dhe lëreni të ftohet, ose zvogëloni ngarkesën derisa pajisja elektrike të funksionojë siç duhet.
